



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:107272

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06313581

C.nr.152/23

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit M.M.e punësuar në SHFMU “I.M” në Malishevë, të cilën me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim e mjeteve në emër të shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës me date 17.10.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hedhet poshtë** si e palejueshme padia e paditësit M.M.e punësuar në SHFMU “I.M” në Malishevë e parashtruar kundër të paditues Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar kompensim e shujtave për 542 ditë në shumën prej 1,084.00 euro dhe shpenzimeve të udhëtimit për 542 ditë në shumën prej 1,518.00 euro euro në shumën e përgjithshme prej 2,602.00 euro.
- II. Secila palë** i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi M.M.e punësuar në SHFMU “I.M” në Malishevë përmes të autorizuarit të saj Av. Zahir Hamza nga Prishtina në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, sipas padisë paditësi është e punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “I.M” në Malishevë, paditësi i sipërshënuar i plotëson kushtet e përfitimit në emër të shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendojmë se u takon kompensimi, gjykatës i ka propozuar të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit..

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar padinë e paditësit poashtu në përgjigje në padi, e paditura e ka kontestuar edhe afatin ligjor të paraqitjës së padisë, duke konstatuar se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor, gjykatës i ka propozuar të refuzojë padinë si të pa bazuar për nga abza ligjore e saj.

Meqenëse e paditura me anë të parashtrësës së përgjigjës në padi ka deklaruar duke e kontestuar afatin e parashtrimit të padisë, gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se padia e paditësit është e pas afatshme.

Nga shkresat e lëndës, të bashkangjitura, veçmas shiqimit të padisë, provave me anë të së cilave mëtohet të vërtetohet gjendja faktike, gjykata vërtetoi faktin se paditësi padinë e ka parashtruar me datë 20.03.2023, ndërsa kërkesa e padisë rezultoi e kërkuar për periudhën 2017-2020 gjë që rrjedhimisht nga koha e të drejtës së realizimit të kërkesës, përkatësisht nga koha e të drejtës për parashtrimin e kërkesës për realizimin e të drejtës në kompenzimin e mjeteve e deri në parashtrimin e padisë kanë kaluar më shumë se 3 vite, duke e tejkaluar kështu afatin ligjor sipas dispozitave të Ligjit të Punës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohën se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, andaj meqenëse paditësi padinë e ka parashtruar pas kohe, pas shqyrtimit të përgjigjës në padi, theksimeve të saj dhe pas fazës së shqyrtimit paraprak të padisë bazuar në nenin 391 pika (f) e LPK-së përcaktohet se **“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”** duke e ndërlidhur dhe interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 404 par.1 dhe 2 ku përcaktohet se **“Pas parashtrimit të pretendimeve të padisë dhe përgjigjës në padi kalohet në shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pengesat për procedim të mëtejme të çështjes juridike. Lidhur me pengesat procedurale mund të merren prova po që nevoja për një gjë të tillë”**, ndërsa në par.2 përcaktohet se **“Gjykata, sipas prapësimit të palës apo sipas detyrës zyrtare, do të vendosë mbi çështjet nga neni 390 të këtij ligji, po që se me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe”**, në rastin konkret gjykata vlerëson se kërkespadia është e jashtë afatshme dhe si e tillë është e parashkruar dhe se nuk u lëshua në shqyrtimin e provave të tjera.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konformë nenit 38, nenit 391.pika (f) dhe nenit 404 par.1 dhe 2 të LPK-së.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.152/23 me datë 17.10.2024**

**Gjyqtari
Nehat Qelaj**

Këshilla juridike:Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.